

342.7:34(37)

Zinet Asani¹

**NDIKIMI I KONCEPTIT ROMAК NË MBROJTJEN E TË
DREJTAVE SUBJEKTIVE CIVILE NË KOHËN MODERNE**

**ВЛИЈАНИЕТО НА РИМСКИОТ КОНЦЕПТ ВО ЗАШТИТА НА
СУБЈЕКТИВНИТЕ ЦИВИЛНИ ПРАВА ВО МОДЕРНОТО
ВРЕМЕ**

**IMPACT OF THE ROMAN CONCEPT IN THE PROTECTION OF
CIVIL SUBJECTIVE RIGHTS IN MODERN TIMES**

Abstract

The Roman law in periods of its development conveyed to the dictates of slave society and the further of social and civilized development it is recognized as a inexhaustible source and a rich heritage in the framework of which was built the legal Euro-continental order accepted outside the continent.

Nowdays definition for Law and Lawfulness stands behind the definition of the Roman law, which I will present in this paper, so the historical past elaborating the concept of Lawfulness understood by lawyers Roman as a constant endeavor to give the rights that belongs to each person ².

The procedural justice system *cognitio extra ordinem* as the last stage of legal protection in civil rights has enabled changing legal composition of the actio of the legislative procedure and forms of individual character, in Civil subjective right. However, in modern procedures where the existence of lawsuits general presents theoretical ruler concept, individual nomination *actio* (the lawsuit) is still preserved, so even to this day there are lawsuits which nominated as lawsuits: reivindicatio, negatoria, paulians, quinas etc.

¹ Dr, Fakulteti i shkencave juridike - FON Universiteti -Shkup,
zinet.asani@fon.edu.mk

² Roman jurist Ulpian established three requirements of the law: “Living with honor, do not done harm to anyone and to given to everyone what belongs” Ulpian D.1,1,10,1 Ulpianos libro primo regularum/Iuris praecepta sunt haec:honeste vivere, alterum non laedere, suum cuique tribuere/”.

The meaning of Roman law in the Middle Ages in Europe conveyed Roman concepts on the basis of which were constructed civil codes that are valid today in European countries as a positive right. It should be noted that the universality of Roman law and its legal concepts are present in the positive law of the Republic of Macedonia especially in the sphere of private property and its legal protection.

This work will enable to draw out points liaison between Roman concepts and those contemporary with the aim to give response to that: *What is left today of the Roman concepts and to what extent are followed and interpreted concepts and legal remedies to this judicial tradition?*

Key words: Roman law, Roman civil procedure, Interpretation of Roman law, Roman universality.

Abstrakt

E drejta romake në periudhat e zhvillimit të saj përcolli diktatet e një shoqërie skllavopronare dhe në zhvillimin e mëtejshëm shoqëror dhe civilizues ajo njihet si burim i pashtershëm dhe një trashëgimi e pasur në kuadër të së cilës është ndërtuar rendi juridik eurokontinental i pranuar edhe jashtë kontinentit.

Nocioni i sotëm mbi të drejtën dhe drejtshmërinë qëndron pas atij të Romakëve për të cilin në këtë punim do të rikujtojmë atë të kaluar historike duke elaboruar konceptin e drejtshmërisë i kuptuar nga juristët romak si një përpjekje e përhershme që secilit t'ki jepet e drejta që i takon³.

Sistemi gjyqësor procedural *cognitio extra ordinem* si fazë e fundit e mbrojtjes juridike të të drejtave në fushën civile ka mundësuar ndryshimin e përbërjes juridike nga actio e procedurës legjislativë dhe formulare me karakter individual, në të drejtë subjektive civile. Megjithatë, në procesualistikën moderne ku ekzistimi i padive gjenerale paraqet koncept teorik sundues, emërimi individual për actio (padinë) edhe më tej është i ruajtur, kështuqë edhe sot e kësaj dite ekzistojnë padi të cilat emërohen si padi: reivindikatore, negatore, publicijane, pauliane, akvilijane etj.

Recipimi i të drejtës romake në Mesjetë përcolli edhe në Evropë konceptet romake mbi bazën e të cilave u ndërtuan kodet civile që sot e kësaj dite vlejshëm në shtetet evropiane si e drejtë pozitive. Vlen të potencohet që univertialiteti i të drejtës romake dhe konceptet juridike të saj janë të pranishme edhe në të drejtë pozitive të Republikës së Maqedonisë sidomos në sferën e pronës private dhe mbrojtjes juridike të saj

³ Juristi romak Ulpiani I themeloi tri kërkesat të të drejtës. "Të jetosh me nder, mos t'i bëhet dëm askujt dhe secilit t'i jepet ajo që i takon". Улпијан. *D.1,1,10,1/Ulpianus libro primo regularum/Iuris praecepta sunt haec:honeste vivere, alterum non laedere, suum cuique tribuere*".

Ky punim do të mundësojë të nxirren në pah pikat ndërlidhëse midis konceptet romake dhe ata bashkëkohore me qëllim dhënie të përgjigjes lidhur me atë se: *Çka ka ngelur sot nga konceptet romake dhe deri në cilën masë janë përcjellë dhe recipuar konceptet dhe zgjidhjet juridike të kësaj tradite juridike?*

Fjalët kyçe: e drejta romake, procedura civile romake, recipimi i të drejtës romake, universaliteti romak.

Hyrje

E drejta romake paraqet bazën juridike të sistemeve të të drejtës moderne evropiane.

Qëllimi i studimit të kësaj të drejte, para së gjithash studimi i koncepteve, instituteve dhe parimeve të saj, paraqet hulumtimin e rrugës drejt perfeksionimit të së drejtës.

Elaborimi i temës “Ndikimi i konceptit romak ndaj mbrojtjes të drejtave subjektive civile në kohën moderne” nuk është tentim për të risqaruar situata të caktuar juridike në fushën e procedurës gjyqësore civile, por para së gjithash paraqet një qasje intelektuale për elaborimin e një gjeneze, një trashëgimie apo një kontinuiteti juridik të vazhdueshëm, i cili realizon këtë traditë juridike që me një vitalitet jo të zvogëluar vazhdon edhe sot.

Duke pasur parasysh se e drejta romake paraqet një tërësi juridike të sistemuar, të strukturuar konceptualisht dhe institucionalisht, ndikimi i saj në shtetet me përbërje të sistemit juridik eurokontinental, por edhe më gjerë ka qenë evident. Kjo është edhe arsyeja që ky punim të pasqyrojë “jetësimin” e instituteve të saj në legjislacionet moderne, e në rastin konkret në sferën e procesualistikës dhe dimensionin proceduralo-juridik të bazuar në konceptin në fjalë. Në këtë kontekst mund të flitet për një kontinuitet dhe diskontinuitet të parimeve mbi të cilat mbështetet procedura civile romake deri tek format bashkëkohore të dedikuara për mbrojtjen e të drejtave subjektive civile.

Perandoria Romake si një formacion shoqëror i caktuar, me Perandorin Justinijan përfundoi zhvillimin e saj të brendshëm autentik, dhe në gërmadhat e saj vazhduan të zhvillohen doktrinat juridike të shteteve të ndryshme të cilat recipuan nga e drejta romake institute dhe koncepte të rëndësishme juridike e me kalimin e kohës u krijua një e drejtë e cila nuk mund të thuhet se ishte e drejtë romake edhe pse burimisht i takonte asaj. Bëhet fjalë për të drejtën Pandektiane apo Usus

modernum pandectarium⁴. Sistemi në fjalë nuk është bazuar në parimet universale të klasifikimit pasi që e drejta sendore dhe ajo obligative janë të ndara e në suaza të të drejtës familjare dhe trashëgimore të cilat karakterizohen si tërësi sistimore, të gjithë rregullat të cilat janë të ndërlidhura me këta dy fusha të realitetit social janë të vendosura në një vend. Sistemi pandektist gjeti aplikimin e tij në të drejtën private gjermane si rezultat i asaj që e drejta obligative është përcaktuar si fushë juridike në vete.

Koncepti mbrojtje e të drejtave subjektive civile në procedurën gjyqësore romake ka pasur ndikim crucial në rregullimin e shoqërisë romake. Duke pasur parasysh funksionalitetin e saj në fillim të paraqitjes të këtij koncepti i rregulluar sipas normave të jus civile të vjetër, kur intervenimi i organeve shtetërore në kontestet midis qytetarëve ka qenë i rastësishëm, jo i sistemuar dhe ku mungonin rregullat e shkruara përmendet mbrojtja e të drejtave të individit me forcën e vet e cila zgjat një kohë të gjatë në shoqërinë romake.

Krijimi i rregullave të shkruara dhe organeve shtetërore të caktuara ju mundësoi qytetarëve romak mbrojtjen e të drejtave të tyre ta kërkojnë para organeve shtetërore për shkak të sigurisë, se në këtë mënyrë më lehtë do ti realizojnë të drejtat e tyre. Pra, flitet për themelimin e procedurës gjyqësore civile e cila fillimisht lindi si metodë primitive e mbrojtjes, mjaft konservative dhe me një formalizëm të tepruar.

Periudha klasike solli me vete procedurën formulare e në periudhën postklasike parashihet një proces më bashkëkohor për mbrojtjen e të drejtave subjektive civile sipas një procedurë gjyqësore më të rregullt dhe sipas mundësive të reja për mbrojtje procedurale. Kjo është periudha kur procedura në fjalë mori fizionominë e vet përfundimtare e cila është shumë e ngjashme me procedurën moderne civile dhe shumë më e largët nga aspekti i koncepteve dhe instituteve si dhe rrjedhës së procedurës me procedurat romake paraprake. Për këtë arsye vërtetohet teza se koncepti romak mbi mbrojtjen e të drejtave subjektive civile është evident në të drejtën e kohës moderne në të gjithë ata shtete të cilat burimisht dhe tradicionalisht janë pjesë e familjes eurokontinentale e cila u zhvillua nën traditën juridike romake.

⁴ Zimmerman R., The law of Obligations, Roman Foundations, of The Civilian Tradition, Juta & Co, Ltd. Po., I st Ed., 1990, reprinted 1992, Box 14373, Kenwyn 7790.

Koncepti romak mbi mbrojtjen e të drejtave subjektive civile gjen shprehje edhe në të drejtën pozitive të Republikës së Maqedonisë e cila si suksesion i ish-Federatës jugosllave u zhvillua nën konceptin romak dhe traditën romake.

1. Aspekte teorike mbi zhvillimin e procedurës gjyqësore romake në sistemin juridik romanist dhe çështjes të mbrojtjes të të drejtave subjektive civile

E drejta e kohës moderne në pjesën e saj më të gjerë është produkt i përvojave, kujtesave historike si dhe rregullave të adoptuara nga tradita civilizuese romake.

Autorët bashkëkohor⁵ në veprat e tyre shpesh shërbehen me konceptet, institutet, terminologjinë dhe maksimat e adoptuara nga periudha klasike romake të cilat na bëjnë me dije që këta koncepte juridike kanë luajtur rol të rëndësishëm në themelimin dhe përsosmërinë e të drejtës moderne, e njëkohësisht kanë poseduar rregullshmëri juridike sipas numrit të madh të ligjeve për destinime konkrete.

1.1 Koncepti romak mbi të drejtën subjektive civile

Kategoria e të drejtave subjektive civile është institut i cili i takon të drejtës civile romake. Në periudhën e zhvillimit të hershëm të shtetit romak e drejta subjektive civile ka qenë në pajtueshmëri të plotë me natyrën e marrëdhënieve të atëhershme të krijuara në shoqërinë skllavopronare romake.

Edhe pse e drejta romake ka karakter klasor, normat shoqërore u zhvilluan si norma juridike në periudhën e titoriko-juridike romake themelimit të shtetit romak, e në këtë kontekst vlen të potencohet se me paraqitjen e të drejtës objektive në shtetin romak u paraqitën tendencat njohjen e të drejtave subjektive civile si koncepte juridike me rëndësi relevante.

1.2 Zhvillimi i procedurës gjyqësore romake

Duke iu referuar burimeve historiko-juridike romake zhvillimi i procedurës gjyqësore civile nuk ka qenë i njëjtë në periudhat e ndryshme të zhvillimit të shtetit romak dhe të drejtës romake.

⁵ Shih më gjerësisht te: Поленак-Аќимовска М., Бучковски В., Избор на текстови од римското право, Универзитет “Св. Кирил и Методиј – Правен факултет “Јустинијан Први”, Скопје 2008 11.

Shikuar në retrospektivë, koncepti mbi mbrojtjen e të drejtave subjektive civile ka zanafillën e vet që nga periudha e Romës së vjetër, kur ende nuk ekzistonin rregulla të përgjithshme stabile për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve romak. Instrumentet për mbrojtje të këtyre të drejtave, metodat dhe teknikat ku realizohej kjo mbrojtje në periudhën e vjetër lëvizën në kahje të dyfishtë: filluan nga *legisactio sacramentum*⁶ dhe mbaruan me procedurën klasike formulare (*per formulae*).

Vlen të potencohet që në stadiumet të mëhershme të zhvillimit të bashkësive primitive romake, mbrojtja e të drejtave të qytetarëve realizohej në mënyrë private, e ashtuquajtur instituti i vetmbrojtjes të parregulluar si mënyrë dominuese e barazimit të të gjithë konflikteve, si dhe si reagim i sulmeve ndaj të mirave themelore të bashkësisë dhe të individit.

Vështruar në aspektin komparativ, në procesualistikën moderne, vetëmbrojtja paraqet sigurimin e të drejtës të individit me anë të aksionit faktik të tij pa iu drejtuar gjykatës. Është e lejuar me përjashtime vetëm në ata situata kur sipas rrethanave nuk mund të pritet mbrojtje efikase nga organet e autorizuara, e pa këtë mbrojtje e drejta do të ngelej e shkelur Ajo lejohet në disa forma të saj⁷.

Në të drejtën romake për dallim nga e drejta moderne procedura civile nuk dallohej nga e drejta materiale. Në kontekst të këtij fakti mund të konkludohet që sistemi juridik në periudhën klasike sendërtoi një sistem të ashtuquajtur “Sistem i padive”, por jo edhe një sistem të të drejtave.

Në procedurën formulare vlen të potencohet veprimtaria e pretorit⁸ i cili si organ i jurisprudencës me mjete të veçanta për mbrojtje të të drejtave të qytetarëve (*stipulationes praetoriae*, *missiones in possessionem*, *interdicta*, *restitutio in integrum*), ndikoi në procedurën e atëhershme formulare duke e plotësuar dhe ndryshuar atë, duke i shqyrtuar lëndët gjyqësore dhe duke sjellë vetë vendimet mbi rastet e shpeshta dhe të paparashikuara civilo-juridike. Në këtë kontekst mund

⁶ Shih te Zimmerman R., *The law of Obligations, Roman Foundations, of The Civilian Tradition*, Juta & Co, Ltd. Po., I st Ed., 1990, reprinted 1992, Box 14373, Kenwyn 7790.

⁷ Shih. Групча А., Улогата на римското право во формирањето на новото и современото граѓанско (имотно) право, Зборник во чест на Иво Пухан, Универзитет “Св.Кирил и Методиј”, Правен Факултет, Јустинијан први, Скопје, 1996, 47.

⁸ Petrak M., *Kritika teorije samopomoci kao prvobitnom obliku pravne zashtite*, Izvorni znanstveni rad, prosinac 2005 74.

të konkludohet se në situatat e krijuara vihet re paraqitja e finesave të para të procedurës kognistike.

Në procedurën e re si lëndë të para që filluan të shqyrtohen dhe për të cilat jepej zgjidhje ishin ata mbi trashëgiminë dhe kontestet nga lëmi i marrëdhënieve të krijuara midis prindërve dhe fëmijëve, kontestet të ndërlidhura mbi lirinë dhe robërinë (jus ad personae pertinet-liberales causae), si dhe lëndët lidhur me interesin publik. Kjo është edhe arsyeja që romanistët sot, me plot të drejtë vërtetojnë rëndësinë e koncepteve të kësaj procedure në procedurën gjyqësore moderne, që në këtë punim për shkak të rolit të saj të shumëfishtë në sistemin e të drejtës do të elaborohet në mënyrë më të detajuar. Pra, bëhet fjalë për një kthesë në sistemin procedural në të cilin hasim në fuqizim të organeve të jurisprudencës të cilët kryenin funksionin e tyre të bazuar në reformat që ndërmerreshin në këtë periudhë dhe ndryshimet serioze që pësuan nga këta reforma, e me këtë u mundësuan ndryshime edhe në jurisprudencë.

Sistemi *actio* (i padive), u ndryshua dhe u reformua në “Sistem të të drejtës subjektive civile” pasi në skenën procedurale-juridike filloi të veprojë *Cognitio extra ordinem*. Nga aspekti organizativ kjo përbërje filloi të realizohet sipas veprimtarisë të organeve të reja të organizuara në një rrjetë hierarkike gjyqësore. Në aspektin e rregullave funksionale flasim për një mënyrë të veçantë juridiko-publike të mbrojtjes të të drejtave të qytetarëve e cila fizionominë e vet përfundimtare e arriti në të Drejtën Justinijane si procedurë e rregullt gjyqësore civile. Edhe rregullat e dyshkallshmërisë të procedurës për Justinijanin u pranuan si formë përfundimtare e këtij procesi të tipit liberal (të shkruar), por me karakter të theksuar etatist.

Karakteristikat e procedurës të re të krijuar vështrohen nga veprimtaria e Princepsit i cili tentonte që pushtetin e tij, nëpërmjet të drejtës ta mbjellë në të gjithë sferat e shoqërisë romake. *Cognitio extra ordinem* zhvillohej para gjykatësit individual. Gjatë gjithë periudhës të zhvillimit të saj kjo procedurë manifestoi disa veti të përbashkëta dhe të përgjithshme dhe atë: mosekzistimi i ndarjes të procedurës gjyqësore në *in jure* dhe *apud judicem*, pamundësia e palëve në zgjedhjen e gjykatësit, zhdukjen e formulës e në pajtim me këtë edhe urdhëresat në të cilat gjykatësi privat duhej t’u përmbahej gjatë zbatimit të të drejtës në procedurën formulare. Procedura në mënyrë të plotë ka qenë në koordinim me pushtetin publik dhe e zbatonte gjykatësi profesional i arsimuar si jurist dhe si nëpunës shtetëror, i zgjedhur dhe i përcaktuar

nga Perandori i cili vepronte në emër të tij dhe nën mbikëqyrjen e tij duke e zbatuar të drejtën perandorake.

Procedura extra ordinem nënkupton njërën nga format më subtile që trajtonte çështjet më kryesore në rregullimin e shoqërisë romake por rëndësia e saj shihet edhe në zhvillimin e procedurës civile moderne ku dominojnë konceptet dhe institutet si dhe mënyrat e realizimit të rrjedhës të kësaj procedure.

2. Recipimi i të drejtës romake

Procesi i recipimit⁹ të të drejtës romake në Evropën Perëndimore sipas romanistëve të kohës moderne parashihet në tri faza:

- Faza e parë, parasheh ringjalljen e të drejtës romake në Itali nga fundi i shekullit XI deri në fillim të sh. XVI. Në këtë periudhë të zhvillimit të të drejtës parimet, terminologjia dhe tërësia strukturale e të drejtës romake ishin të përmbledhura në të drejtën mesjetare, që më vonë do të gjejnë përdorimin e tyre si bazë e kulturës juridike të për-bashkët evropiane e bazuar në konceptet juridike të Corpus juris civilis të Justinijanit dhe të përpunuara nga glosatorët dhe komentatorët (interpretuesit) të cilët inkorporuan këta koncepte, zakone dhe praktika tregtare posaçërisht atyre të Italisë Veriore¹⁰ në Jus commune Europeaine.

- Faza e dytë, i takon periudhës prej sh.XVI deri në mesin e shekullit XVIII, ku vjen në shprehje paraqitja e shteteve nacionale dhe në kontekst të kësaj edhe zhvillimin e sistemeve juridike nacionale të themeluara sipas parimeve të *Jus commune Europeaine*.

Ndikimi i kësaj të drejte dhe parimeve të saj në aspektin teorik dhe praktik, sollën krijimin e universiteteve të reja ku studiohej shkenca juridike tradicionale. Megjithatë, vlen të potencohet që edhe pse kjo e drejtë ishte përvetësuar për gjetjen e zgjidhjeve lidhur me problemet e krijuara të kohës bashkëkohore, jus commune filloi të distancohet nga e Drejta Justinijane prej të cilës nxori autoritetin e saj. Në suaza të kësaj, filloi të vjen në shprehje zbatimi universal i së drejtës romake si bazë e përmbajtjes të saj juridike.

⁹ Shih më gjerësisht te: David R., Les grands systems de droit contemporains, Paris, 1978, vo javno i privatno pravo, Skopje, 1998, 87.

¹⁰ Shih: Ковачевік –Куштримович Р., Сто педесет година од доношења СГЗ, Зборник радова Правног факултета у Нишу со научног скупа „ Сто педесет година од доношења СГЗ, 1844-1994 112.

• Shekulli XVIII dhe XIX i takon fazës së tretë të recipimit të së drejtës romake. Kjo dëshmon paraqitjen e Kodeve civile nacionale të së drejtës në Evropën Perëndimore dhe përvetësimin e kodekseve nga shumë shtete jashtë Evropës perëndimore.

Recipimi i së drejtës romake vazhdoi të ndjehet fuqishëm në secilin sistem juridik në botë me përjashtim të atyre shteteve të cilët i ishin bashkangjitur traditës të së drejtës zakonore (sistemi anglosakson). Vlen të potencohet se edhe sistemi juridik i SHBA-së i cili nënkuptohej si Sistem i Common law, gjysmë shekulli para pavarësisimit e ndjeu mundësinë që e drejta private të mbisundojë. Kjo, p.sh: ndodhi në Luizianë e cila në vitin 1825 solli kodeksin romanist të bazuar në të drejtën franceze dhe spanjolle.¹¹

Në teorinë juridike është e njohur edhe ajo se pas revolucionit amerikan kanë ekzistuar simpati ndaj ndikimit juridik francez. E drejta civile dhe ajo natyrore ishin elementet juridike më kryesore të edukimit juridik dhe lexoheshin nga juristët amerikan sepse për ta Civil law ishte potencialisht më entuziaste. Megjithatë profesioni jurist i këtyre juristëve ndoshta ka qenë faktori qenësor që të humben idetë dhe mendimet ndaj të drejtës romake si një ndikim potencial në Common Law sistemin e së drejtës.

3. Kodifikimi i të drejtës civile si koncept i të drejtës romake dhe perspektivat e tij në zhvillimin e të drejtës moderne

Procesi i kodifikimit të të drejtës njihet nga periudha e Shekullit të vjetër, përkatësisht e 12-tabelave¹² dhe periudhës Justinijane në të cilën periudhë u kodifikua e drejta romake në tërësi. Ky proces nuk ndaloi këtu pasi sot në kohën moderne në të cilën tentohet drejt unifikimit të të drejtës private në kuadër të Unionit evropian, me të vërtetë Jus commune sot mund të shërbejë si model për unifikimin e të drejtës private evropiane në mbarë Evropën.

Për shkak të vlerave të tilla, e drejta romake paraqet një civilizim tradicional me vlerë në ndikimin e të cilit mbështetet një pjesë bukur e gjerë dhe mjaft e rëndësishme e të drejtës moderne apo trashëgimisë civilizuese që i takon kohës moderne.

¹¹ Code civile, anote d apres la doctrine et la Jurisprudence, Dalloz, Paris 1947, The Franch Civil Code (translated by J H Crabb), New Jersey, 1997

Romanizimi i të drejtës dhe instituteve juridike paraqet proces sipas të cilit e drejta romake për shkak të mos harresës të saj gjatë periudhës të “shekullit të errët” u reformua në atë masë dhe u krijua si Jus commune në pjesën më të madhe të Evropës Perëndimore, duke plotësuar por edhe në të shumtën e rasteve duke zëvendësuar të drejtën zakonore feudale, e cila dominonte në këtë periudhë. Ky ishte proces i racionalizimit intelektual dhe teknik në pajtueshmëri me natyrën e shtetit modern, sidomos monopolit të tij në udhëheqjen me të drejtën.

I njohur si recipim i të drejtës romake, ky proces mund të përshkruhet si trend, veçanërisht në Evropën Perëndimore duke sinjalizuar ndryshimet në këta shtete dhe fushat juridike të cilat ishin përfshirë me të.

Zbatimi universal i të drejtë romake dhe koncepteve të saj si bazë e Jus commune, filloi të arrijë në pikëpyetje fillimisht nga humanistët e sh.16 e pastaj edhe nga sh.17 nga përkrahësit e shkollës natyrore. Në mesin e sh.18 dhe deri në fund të sh.19 dëshmohej për paraqitjen e kodifikimeve nacionale të të drejtës në Evropën Perëndimore. Përvetësimi i kodeve të para moderne nga ana e shteteve tjera solli në një recipim të mëvonshëm të të drejtës romake jashtë Evropës perëndimore duke u ndje fuqishëm ndikimi i të drejtës romake.

Kodifikimi në vendet evropiane ishte proces i rëndësishëm i inspiruar nga ana e juristëve të atëhershëm për themelimin e kodeve civile për shkak të krijimit të një harmonie të tërësishme juridike në frymën e kohës. Me hyrjen në shekullin e ri kodifikimi i dha fund të drejtës romake dhe të gjitha ata shtete krenarë në vlerat tradicionale të tyre përvetësuan kodet e veta për rregullimin e fushës civile (Franca, Austria, Gjermania, Holanda, Zvicra, Serbia etj.)

Në sh.18 filloi ndryshimi i të drejtës private evropiane dhe mendohet se në historinë e kësaj fushe po bëhej një kthesë e madhe d.m.th., ajo që sot haset në numrin më të madh të shteteve evropiane është e drejta civile e përmbledhur në një kod, që në të vërtetë i prezenton rregullat të ndërlidhura me sfera tjera në një formë të tërësishme sistematike.

Është fakt i pamohueshëm se kodifikimi është një proces i rëndësishëm sepse vendet me ligje të njëjta apo të ngjashme duhet të bashkëpunojnë shumë më lehtë dhe më shpejt midis tyre.

Ky proces i rëndësishëm që edhe sot ndodh në më shumë vende të kontinentit shërben si një alarm se ngjashmëritë të cilat ndërlidhin

sistemet juridike të shumta mund të jenë bazë për shkencën juridike panevropiane apo globale.

Bashkimi i Evropës paraqet frytin e traditës evropiane shumëshekullore të themeluar në kuadër të romanizimit të hapësirës evropiane të krijuar nga Perandoria romake, si dhe ndaj humanistëve antik si fundamente të rëndësishme dhe të fuqishme të civilizimit evropian.

4. Ndikimi i konceptit romak ndaj mbrojtjes të të drejtave subjektive civile në Sistemin procedural të së drejtës të Republikës së Maqedonisë

Ndikimi i konceptit romak mbi mbrojtjen e të drejtave subjektive civile ka gjetur shprehje edhe në sistemin procedural të Republikës së Maqedonisë. Kjo dëshmohet fillimisht duke pasur parasysh se në themel ky sistem juridik është suksesion i sistemit juridik të ish-RSFJ-së i cili i takon familjes eurokontinental e i zhvilluar nën traditën juridike romake. E gjithë kjo përmendet nga fakti i implementimit të koncepteve romake që sqaron se tradita juridike maqedonase juridike buron nga trashëgimia juridike e të drejtës romake dhe atë nisur nga vetitë që i posedonte shkolla gjermano-juridike ku bën pjesë edhe e drejta maqedonase në të cilën janë evidente konceptet romake të të drejtës.

Universaliteti i të drejtës romake vështrohet edhe në aktualitetin e të drejtës procedurale maqedonase në të cilën janë implementuar konceptet romake të adoptuara në të drejtën e procedurës civile si dhe instrumenteve ligjore për mbrojtjen e të drejtave subjektive civile, më konkretisht, paditë, llojet e tyre si dhe mjetet për mbrojtje juridike të rregullta dhe të jashtëzakonshme.

Conclusion

The influence of the Roman concept in modern law is not only present in notions, institutions, substantive rules and legal doctrines but also in judicial proceedings and its techniques, especially in its casuistic analysis¹. As an important concept of law is established in a distant past within the legal system of the Roman state that can easily be verified that its tracks in order to modify and reform adapting to the conditions and circumstances of the time have found support even in the modern era.

The concept of “civil subjective right” presents basic legal category to which the entire legal system is based on Roman private

law. At the beginning of the development of Roman society presents institute which has been in full compliance with the nature of the relationship of slave which then regulated by social norms in its full meaning and its legal nature belongs right Justinian period. In this context it can be concluded that the protection of this category of rights is a concept that belongs to the period of *extra cognitio ordinem* procedural composition as the last stage in the development of legal protection if those private or social interests.

The extraordinary procedure is evaluated by modern processors and modern previous court proceedings, as this litigation for the institutes and its flow is much closer to the modern civil proceedings than with previous civil Roman proceedings. This is indicated by the fact that the flow of its institutions and its concepts and instruments for the legal protection of individual rights civil providing opportunities has today Roman law contemporary perspective. This approach encompasses the issue conceptual legal protection of individual civil rights and simultaneously recognizing the rough with the Romans intellectual skills and scientific, the reasoning of their rights and their commitment to technical legal Roman built and perfected the right and simultaneously realizing opportunities for legal protection.

The period of codification of customary rules in Roman society otherwise Law of 12-tables provides a proper explanation on the emergence of ideas and trends for Roman jurists on the rule of law. This Code followed the Roman jurists ideas conveyed between the principle "Everyone is equal before the law". This principle sent a strong message in Roman society that implementation of the Code should be unique for all Roman citizens and not become his distortion of the strongest or the ruling class. The principle in question occupies an important position and presents a constitutional principle in the modern era for all those legislations which are established under the democratic spirit.

When it comes to the codification of private law in the modern era it can be defined that the process of codification in this period is the most significant achievement in the development of law. Action is the period of natural school and this process was already closed activities of the universities of the middle Ages who had a purpose, creating a general and universal right for all European citizens. The advantages of this model were clear. It is a process of early capitalism and quite necessary for the bourgeois class for the establishment of national states with a common market. With this legal value initially mentioned

France, then Austria, Germany, Serbia, Italy and a range of other countries that belonged to the euro-continente family countries with a legal system based on the Roman tradition. The importance of this process was initially the basic pillars change of law by removing the spirit of the past, disconnecting the old privileges and replacing them with the principles of freedom and dignity of the individual. All this took place, according to the natural law school meaning that constituted the basis of the new social order established.

The protagonists of this process have expected creation of a right to one universal action which would apply to the courts of all states and the termination of legal particularismus in one national state. They believed that the codification of the law will be brought to one unity system of law that shows how important it has been monitoring the concepts Roman and its meaning between the process of interpretation, where in this process special attention is devoted *Corpus Juris civilis* as one legal instrument, a conglomerate of legal norms, institutions and notions accepted in every environment and every situation as one “general right” in Europe., or European community law / *ius commune* /.

Ius commune europeain connects ancient opinion and legal opinion on the common grounds of a legal system in modern times considering the non-destruction of legal tradition in modern European-process and globalization. Legal basis of *ius commune* in greater measure consists of Roman law interpreting that enables us to define that Roman law has provided a special contribution and represents a standard of living of European civilization as in its essence and in meaning that today it is living in. Roman legal experts believe that the creation of European private law, legal science, which departs from the foundation Roman legal tradition common ground (common core) establishes legal rules that respond to the needs of modern times. The large number of civil law experts thinks that the past few years in both legislation and practice in European countries outside Europe also made the return in most cases the concrete forms, legal structures and institutions of Roman law. Can be defined for this modernization “Roman interpretation” does not prevent changes in the cultures and traditions of civilization.

It is well known that the Republic of Macedonia belongs to the Euro-continental law system. So our legal tradition belongs to the Roman-German family. Until the independence of the Republic of Macedonia, the Macedonian judicial system experienced many challenges

and vicissitudes. In view of the codification of civil law, the Republic of Macedonia needs to build a modern legal system which will be in accordance with European Union law. In this direction it is formed Commission for its codification. The results of the codification process will lead to the strengthening of legal certainty meaning. a place will be found national law, international and comparative strengthening of intertwining between theory and practice which will be identical for all, building a more stable pro-European orientation of a single market and the rule of law and rule of law in the Republic of Macedonia.

Macedonia in the procedural dimension is defined between judicial procedures and other institutions to enable citizens to effective judicial protection regarding their rights violated or infringed. Regarding the protection of civil rights, there is a particularism subjective laws, regulations and functional organizational and procedural law in court proceedings. Some of these rules are contained in procedural and substantive laws.

The Roman Concept is present when it comes to defend the individual civil rights launched by the institute of self-defense, the course of judicial proceedings civil with all phases present at and instruments which are initiated in cases where allegedly committed breach or violation of the rights of the individual. The Roman concept is also present in the institute remedies as those regular but also extraordinary to find expression when the party is unhappy at the conclusion of judicial decisions.

Referencat

- Code civile, anote d apres la doctrine et la Jurisprudence, Dalloz, Paris 1947, The Franch Civil Code (translated by J H Crabb), New Jersejy, 1997

- David R., Les grands systems de droit contemporalis, Paris, 1978, vo javno i privatno pravo, Skopje, 1998

- Групче А., Улогата на римското право во формирањето на новото и современото граѓанско (имотно) право, Зборник во чест на Иво Пухан, Универзитет “Св. Кирил и Методиј”, Правен Факултет, Јустинијан први, Скопје, 1996

- Ковачевиќ –Куштримовиќ Р., Сто педесет година од доношења СГЗ, Зборник радова Правног факултета у Нишу со научног скупа „ Сто педесет година од доношења СГЗ, 1844-1994.

- Поленак-Аќимовска М., Бучковски В., Избор на текстови од римското право, Универзитет „Св.Кирил и Методиј – Правен факултет “Јустинијан Први”, Скопје 2008.
- Petrak M., Kritika teorije samopomoci kao prvobitnom obliku pravne zashtite, Izvorni znanstveni rad, prosinac 2005.
- Zimmerman R., The law of Obligations, Roman Foundations, of The Civilian Tradition, Juta & Co, Ltd. Po., I st Ed., 1990, reprinted 1992, Box 14373, Kenwyn 7790.